

VENDIM
Nr. 923, datë 26.12.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 870, DATË 12.12.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURËS SË
PROKURIMIT PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr. 870, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Lejimin e Entit Kombëtar të Banesave të përfundojë, brenda datës 31 dhjetor 2012, procedurën e prokurimit, me objekt “Përkthim, redaktim dhe përshtatje të eurokodeve nga 0 në 3”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2012. Brenda këtij afati përfshihet edhe publikimi i kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike në Agjencinë e Prokurimit Publik.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha